



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_ / \_\_\_ / 2021

### V E N D I M

**Nr. \_\_\_\_, Datë \_\_\_ / \_\_\_ / 2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 115 Regj, datë 16.06.2021, të paraqitur nga K. N, kundër Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

*Bazuar në deklaratimet e subjektit ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur rezulton se:*

K. N ka formalizuar marrëdhëniet e punës me institucionin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), nëpërmjet Urdhrit nr. 1436/1 prot., datë 09.12.2003, në pozicionin e “Specialistit” në Sektorin e Administrimit të Dokumentave/Drejtoria e Sigurimit dhe Administrimit të Dokumentave pranë DSIK.

Subjekti ankues, shprehet se gjatë marrëdhënieve kontraktuale të punës me punëdhënësin/DSIK ka përmbushur dhe realizuar çdo detyrë që i është ngarkuar, duke punuar me disiplinë të lartë, gjë e cila faktohet nga vlerësimet e punës.

Në vijim, DSIK, nëpërmjet aktit administrativ me nr. 18, datë 22.09.2008 ka ndërmarrë ndaj ankuesit masën disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Subjekti ankues, duke mos qenë dakord me vendimin e DSIK, lidhur me lirimin e tij nga Shërbimi Civil, ka ushtruar të drejtën e tij ligjore duke e kundërshtuar këtë akt, administrativisht, pranë Komisionit për Shërbimin Civil (KShC).

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së z. N, KShC, nëpërmjet Vendimit nr. 160, datë 23.10.2008, ka vendosur *inter alia*:

*“1. Ndryshimin e aktit administrativ nr. 18, datë 22.09.2008 të Drejtorit të DSIK nga “Largim nga Shërbimi Civil” në atë të “Pezullimit nga e drejta e ngritjes në detyrë, për një periudhë deri në dy vjet”.*

*2. Kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës.*

*3. Detyrimin e Institucionit t’i paguajë ankuesit pagën për kohën e qëndrimit pa punë”.*

Ankuesi vijon më tej me ankimin e tij ndaj DSIK, duke parashtruar se, punëdhënësi në mënyrë të padrejtë dhe me qëllimin për të mos zbatuar vendimin e KShC për rikthimin e tij në punë, ka ndërmarrë sërish veprime diskriminuese duke dërguar shkresa pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, për detyrimin e personit të tij për të bërë dorëzimet pranë ambjenteve të DSIK.

Ankuesi shprehet se lidhur me këtë pretendim të DSIK, ka gjetur mirëkuptimin e strukturave Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, menjëherë pas sqarimit të situatës nga ana e tij, dhe se këtë veprim të punëdhënësit e sheh si presion për moszbatimin e vendimit të KShC, lidhur me rikthimin e tij në punë.

Po ashtu, ankuesi, ka përfshirë si pjesë të parashtrimeve, në kuadër të pretendimeve për shkelje të ligjit nga ana e punëdhënësit, edhe veprimin e DSIK për heqjen e certifikatës së sigurisë, vendim<sup>2</sup> i cili përkon me të nesërmen e daljes së vendimit të KShC për rikthimin e tij në punë.

Në rend kronologjik subjekti ankues ka renditur një numër procesesh gjyqësore të zhvilluara ndërmjet tij si punëmarrës dhe DSIK, si punëdhënësi, të cilat datojnë nga viti 2014-2021<sup>3</sup>, ku rezulton se ankuesi, të drejtën për t’u rikthyer në vendin e tij të punës, pranë DSIK, e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ankuesi citon ndër të tjera se: *“Nga pala paditëse/DSIK, janë zhvilluar shumë procese gjyqësore, të përsëritura, me të njëjtën kërkesë padi, dhe që të gjitha i ka humbur. Këto janë përpjekje për të shtyrë ekzekutimin e vendimit të formës së prerë”.*

---

<sup>2</sup> Shkresa me nr. 146 prot., datë 23.10.2008.

<sup>3</sup> Cituar sipas subjektit ankues: Vendim nr. 59, datë 15.10.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Vendim nr. 80-2016-4946, datë 24.10.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Vendim nr. 3483, datë 04.07.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, datë 19.12.2017 dhe i datës 06.12.2018; Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, i datës 27.05.2021

Subjekti ankues, shprehet se: *“Nga mosekzekutimi i vendimit për rikthimin në punë, përveç dëmit ekonomik dhe moral, personal dhe familjar, jam dëmtuar edhe nga ana shëndetësore, të gjitha pasoja të ardhura nga shmangia e zbatimit të vendimit nga pala debitore/DSIK”.*

Subjekti ankues, në lidhje me provimin e gjendjes së tij shëndetësore, shprehet se, gjatë viti 2017 është diagnostikuar me një sëmundje të rëndë hematologjike, dhe në mbështetje të këtij pretendimi ai ka bashkëlidhur në cilësi prove dokumentacionin mjekësor:

- Rekomandim të mjekut të familjes, të datës 19.10.2018, i cili e drejton ankuesin tek pneumologu në institucionin e Dispanserisë.
- “Epikrizë”, e datës 16.12.2019 ku evidentohet të jetë shënuar diagnoza *“Morbus Hodgkin Sklerozë Nodulare”*. Në këtë dokument citohet fakti se: *“Në datën 18.04.2019 i sëmuri paraqitet në Spitalin Onkologjik ku vazhdoi trajtimin për dy cikle dhe më pas trajtimi është përfunduar në spital jashtë shtetit”.*

Z. N, shprehet se e ndjen veten të diskriminuar dhe të pabarabartë para ligjit nga DSIK, pasi edhe pse ka qenë punonjësi i parë i larguar nga DSIK dhe ka një vendim gjykate të formës së prerë për rikthimin e tij në vendin e punës, deri në këtë moment nuk është zbatuar ky vendim, ndërkohë që, ka pretenduar se brenda këtij harku kohor në DSIK ka raste të tjera kur vendimet e formës së prerë të gjykatës, lidhur me rikthimin në detyrë të punonjësve të tjerë, janë zbatuar.

Një pretendim tjetër i ankuesit, si pjesë integrale e parashtrimeve të tij, është edhe fakti se ai ka pretenduar edhe diskriminim të bashkëshortes së tij nga ana e DSIK, të cilin e lidh me faktin e mospajisjes së saj me certifikatë sigurie. Këtë pretendim ankuesi e bazon në shkresën me nr. 1648 prot., datë 13.07.2017 të DSIK, e cila konsiston në përgjigjen negative për pajisjen me certifikatë sigurie për L. A, bashkëshortja e ankuesit.

Në përfundim të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga KMD, shprehimisht: *“Zbatimin e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe vendosjen para ligjit të personave përgjegjës të situatës së krijuar”.*

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>4</sup>, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

**A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për trajtim të padrejtë nga ana e DSIK, përsa i takon moszbatimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës, lidhur me rikthimin e tij në vendin e punës.**

Referuar akteve të dosjes, rezulton se, me datë 22.01.2016, subjekti ankues K. N, ka nënshkruar një kontratë shërbimi përmbarimore me shoqërinë e përmbarimit privat TMA sh.p.k, me objekt: “Ekzekutimin e titullit ekzekutiv “Vendim nr. 160, datë 23.10.2008, të KShC, me debitor DSIK”.

Në vijim të procedurave të saj, Shoqëria Përmbarimore nëpërmjet shkresës me nr. 241 prot., datë 01.02.2016 ka njoftuar DSIK lidhur me kërkesën e ankuesit dhe ka kërkuar prej saj ekzekutimin vullnetar të Vendimit nr. 160, datë 23.10.2008 të KShC.

DSIK duke mos u dakordësuar me kërkesën sipërcituar, ka kundërshtuar gjyqësisht veprimet e përmbaruesit gjyqësor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila nëpërmjet Vendimit nr. 3088, datë 13.04.2016 ka arsyetuar *inter alia*, se: “Nisur nga përmbajta e titullit ekzekutiv është tërësisht i qartë detyrimi që debitori DSIK duhet të kthejë kreditorin K. N në vendin e mëparshëm të punës dhe të paguajë pagën për gjithë periudhën e ndenjes papunë deri në ditën kur do të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës. Në lidhje me kërkesën e paditësit për pezullimin e veprimeve përmbarimore referuar nenit 615 të K.Pr.Civile, nga ana e paditësit nuk

<sup>4</sup> Referuar në vijim me shkurtesën LMD.

*u paraqitën prova mbi bazën e të cilave mund të justifikohet marrja e kësaj mase nga ana e Gjykatës. Në përfundim Gjykata ka vlerësuar që padia duhet rrëzuar si e pabazuar në prova dhe ligj”.*

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e subjektit ankues për mosveprimin institucional të DSIK, përsa i takon shmangies nga detyrimi për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, lidhur me rikthimin e tij në punë, janë bërë objekt shqyrtimi nga gjykata të ndryshme, të shkallëve të para dhe të apelit, të cilat kanë dalë me vendimet përkatëse.

Lidhur me detyrimin e organeve shtetërore për zbatimin e vendimeve të formës së prerë ka një qëndrim të konsoliduar kushtetues, i cili parashikon se:

*“Asnjë organ shtetëror nuk mundet që duke ushtruar aktivitetin e tij publik qoftë edhe për një qëllim të ligjshëm publik të pengojë apo vonojë ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë”.*

Bazuar në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, dhe atë nr.10031, datë 11.12.2008 *“Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”*, janë pikërisht këto institucione, organet kompetente të caktuara me ligj, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

Në rrjedhje të sa më sipër, Komisioneri vëren se, detyrimi i zbatimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës<sup>5</sup> nga ana e DSIK, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhje nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>6</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe për rrjedhje kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

**B. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e DSIK, përsa i takon moszbatimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës, lidhur me rikthimin e tij në vendin e punës, për shkak të “gjendjes shëndetësore”.**

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të

<sup>5</sup> Në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: *“3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.*

<sup>6</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 70, datë 28.04.2021, të KMD-së.

krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “*gjendja shëndetësore*”. Subjekti ankues për të faktuar gjendjen e tij shëndetësore, ka bashkëlidhur dokumentacionin poshtëcitur:

- Rekomandim të mjekut të familjes, të datës 19.10.2018, i cili e drejton ankuesin tek pneumologu në institucionin e Dispanserisë.
- “Epikrizë”, e datës 16.12.2019 ku evidentohet të jetë shënuar diagnoza “Morbus Hodgkin Sklerozë Nodulare”. Në këtë dokument citohet fakti se: “*Në datën 18.04.2019 i sëmuri paraqitet në Spitalin Onkologjik ku vazhdoi trajtimin për dy cikle dhe më pas trajtimi është përfunduar në spital jashtë shtetit*”.

Nga aktet e mësipërme mjekësore, evidentohet se gjendja e rënduar shëndetësore e ankuesit rezulton të jetë dokumentuar në vitet 2018-2019. Por, bazuar në deklaratimet e subjektit apo dhe tërthorazi, në aktet sipërcituar<sup>7</sup> mund të konsiderohet se gjendja e tij shëndetësore është përkeqësuar që gjatë vitit 2017.

Mirëpo, Komisioneri vëren se, mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë nga ana e DSIK, nuk lidhet me “*gjendjen e tij shëndetësore*” të ankuesit, pasi paligjshëmria e DSIK, konstatuar kjo nga vendimet gjyqësore, ka ekzistuar edhe përpara posedimit të këtij shkakut nga ana e z. N, pra përpara vitit 2017, 2018, 2019, periudhë kur ai mund të konsiderohet i dokumentuar dhe i provuar.

Po ashtu, mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë në favor të ankuesit, vijon dhe aktualisht, pra ekziston si i tillë pavarësisht posedimit apo jo të shkakut të pretenduar.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të dokumentacionit bashkëlidhur, rrethanave të shpjeguara dhe kronologjisë kohore të fakteve e ngjarjeve, shkakun e pretenduar nga subjekti ankues, nuk është në koherencë me pasojat e ardhura. Pra, ankuesi *apriori* nuk arriti të provojë ekzistencën e lidhjes së ndërsjelltë mes shkakut të pretenduar dhe trajtimit në mënyrë të padrejtë, apo të pafavorshëm, bazuar në këtë shkak, nga ana e DSIK<sup>8</sup>.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të

<sup>7</sup> Referuar përmbajtjes së tyre, ndër të tjera.

<sup>8</sup> Përfshirë edhe pretendimet e ankuesit, cituara në paragrafin e prafundit, faqe 2 e Vendimit.

pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

C. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim të bashkëshortes së tij nga ana e DSIK.

Si pjesë të parashtrimeve tërësore, ankuesi ka përfshirë edhe pretendimin për diskriminim të bashkëshortes së tij nga ana e DSIK, të cilin e lidh me faktin e mospajisjes së saj me certifikatë sigurie. Këtë pretendim ankuesi e bazon në shkresën me nr. 1648 prot., datë 13.07.2017 të DSIK, e cila konsiston në përgjigjen negative për pajisjen me certifikatë sigurie për L. A, bashkëshortja e ankuesit.

Përsa më sipër, mbështetur në nenin 64<sup>9</sup>, paragrafi 1 dhe nenin 65<sup>10</sup> paragrafi 1, i Kodit Civil, subjekti ankues, që të jetë përfaqësues ligjor i L. A, duhet të legjitimohet të përfaqësojë atë, duke kërkuar në emër dhe me vullnetin e saj të shprehur pranë Komisionerit, që ky i fundit të hetojë për diskriminimin e pretenduar kundrejt DSIK-së.

Në respektim të parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 33, pika 1 citohet: “Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal”, ankuesi duhet të legjitimohet për përfaqësimin e L. A pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Përsa më sipër dhe në kushtet kur subjekti ankues nuk legjitimohet për të përfaqësuar L. A pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t' i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

---

<sup>9</sup> Neni 64, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Me përfaqësimin, një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar)”.

<sup>10</sup> Neni 65, paragrafi I, i Kodit Civil parashikon: “Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuarit caktohen me prokurë”.

Pavarësisht konstatimit të sa më sipër, bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, Komisioneri, konstaton se:

- Subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e DSIK që me datë 13.07.2017, kur dhe i është njoftuar shkresërisht përgjigjja negative për pajisjen me certifikatë sigurie për L. A, bashkëshorten e tij.
- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesi ka marrë dijeni për këtë veprim të DSIK, të pretenduar si diskriminues, që në gjatë muajit korrik 2017<sup>11</sup>. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 16.06.2021**, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga LMD, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, sjellim në vëmendje se ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 34, në pikën 2 të tij, parashikon se: “Paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t’i drejtohet gjykatës”.

Nga ana tjetër, ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 36, pika 1 të tij, parashikon se: “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34<sup>12</sup> të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita kur ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita kur i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”.

Duke qenë se subjekti ankues është brenda afateve të parashikuara në këtë Ligj<sup>13</sup>, për të ndjekur gjyqësisht pretendimin e tij për diskriminim, Komisioneri i rekomandon që t’i drejtohet gjykatës kompetente.

Në këto kushte, referuar nenit 33, pika 4/b të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku citohet: “Ankesa nuk pranohet nëse, është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, edhe kjo pjesë e kërimit të K. N në emër të bashkëshortes L. A, nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të shqyrtimit, pasi nuk plotëson kriteret e parashikuara në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

<sup>11</sup> Fakti i marrjes dijeni nuk evidentohet saktësisht, por citohet në shkresë nga ankuesi.

<sup>12</sup> “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

<sup>13</sup> Neni 36 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Procedura para gjykatës”.



## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues K. N, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim

Shkaku: “Gjendja shëndetësore”

Lloji i vendimit: Mospranim